

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
KOMUNËN PERONDI

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **komunën Perondi, Qarku Berat**, me objekt: *“Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë”*, lloji i auditimit: *“Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare”*, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2013 deri 31.12.2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 71, datë 30.06.2015.

Bazuar në nenet 6, 15, 25 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 240/7, datë 30.06.2015, i ka rekomanduar z. Rexhep Hajdari, Kryetar i Bashkisë Kuçovë, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje: Në Komunën Perondi, janë bërë përpjekje për njohjen, zbatimin dhe implementimin e ligjit nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” lidhur me konceptet dhe komponentët e MFK.

Por nga auditimi u konstatua se ka pamjaftueshmëri dhe paaftësi në përvetësimin e koncepteve të këtij ligji dhe si pasojë reflektohet në mangësitë dhe mosveprimet për ngritjen dhe funksionimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS), GMSBI, EMP, mungesën e hartimit të planit dhe ndjekjes së gjithë hapave për ngritjen e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, nuk ka hartuar e miratuar strategjinë, objektivat, misionin vizionin dhe deklaratën përkatëse. Komuna ka plotësuar, raportuar e dërguar në Ministrinë e Financave formularët pyetësorë të vetëvlerësimit, raportin për funksionimin e kontrollit të brendshëm si dhe planveprimet afatmesme e afatshkurtër, por kanë lënë pa trajtuar aspekte të tjera të ligjit, të cilët i kemi trajtuar gjatë rezultateve të auditimit dhe në ballafaqim me punonjësit përkatës.

1.1 Rekomandimi: Komuna Perondi të marrë masa për implementimin e ligjit nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”

Vazhdimisht

2. Gjetje: Nuk është hartuar dhe miratuar në këshillin e komunës, projektbuxheti dhe buxheti faktik për vitin 2013, 2014 dhe 2015, ky veprim është në kundërshtim me pikën 8 neni 19, nenin 32 e 33, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin e funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar dhe me nenin 17, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës në komunën Perondi të marrë masa, të hartojë dhe miratojë në këshillin e komunës projekt buxhetin dhe buxhetin faktik të vitit financiar.

Vazhdimisht

3. Gjetje: Nuk është llogaritur Fondi rezervë dhe fondi i kontigjencës për vitin 2013, 2014, 2015, deri në masën 3 % të vlerës së përgjithshme të fondeve të

miratuara, sipas kërkesave të nenit 6, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë".

3.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa dhe të miratoj fondin rezervë dhe fondin e kontigjencës deri në masën 3 % të vlerës së përgjithshme të fondeve të miratuara për aktivitetin buxhetor.

Vazhdimisht

4. Gjetje: Planifikimi i shpenzimeve operative për buxhetin e vitit 2013, 2014, 2015, është hartuar me rezervë, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë".

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa, për planifikimin e shpenzimeve operative në mënyrë të argumentuara e në përputhje me nevojat dhe mundësitë reale, me qëllim që të kemi një pasqyrim më të saktë të treguesve të planit të buxhetit komunës.

Vazhdimisht

5. Gjetjet: Gjatë vitit 2011 janë larguar nga puna 12 punonjës, ndërsa gjykata me vendim të formës së prerë ka vendosur detyrimin e komunës Perondi, të paguaj shumën 8,817,715 lekë, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë".

5.1 Rekomandimi: Komuna Perondi të marrë masa, që të gjitha largimet e punonjësve nga puna, të bëhen në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar dhe ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" i ndryshuar.

Vazhdimisht

6. Gjetje: Komuna Perondi për vitin 2013-2014, nuk ka arkëtuar detyrimet debitore nga 205 persona në shumën **9,284,611 lekë**, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 24.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare", ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

6.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa dhe të kërkoj në rrugë ligjore dhe administrative, arkëtimin e shumës **9,284,611 lekë**, nga 205 persona debitorë.

Brenda datës 31.12.2015

7. Gjetje: Nuk janë arkëtuar detyrimet debitore për vitin 2013-2014 në shumën **11,184,850 lekë**, si: taksë e biznesit të vogël, taksa e tokës bujqësore, taksë pasurie dhe tarifë pastrimi, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 24.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare", ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

7.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me sektorin e Taksave, të marrë masa për evidentimin e kontabilizimin e detyrimeve të pa likuiduara, deri më datën 31.12.2014, të nxiren njoftim vlerësimet për taksat e papaguara dhe kamat vonesat si e ardhur e munguar në buxhetin e Komunës Perondi në vlerën prej **11,184,850 lekë**, duke ndërmarrë hapat ligjorë e administrativë, si më poshtë:

a-Dërgimin e urdhrat të bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë".

b-Dërgimin për vendosje të barrës siguruese (për mjetet) Drejtorisë Rajonale të Transportit dhe Zyrës së Regjistrimit (për pasurinë e paluajtshme), bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë".

c-Në rast se subjektet edhe pas dërgimit të urdhër bllokimeve në Bankë dhe njoftimeve zyrtare, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, sipas nenit 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008" ndryshuar me ligjin nr. 164/2014, datë 04.12.2014, pasi të vendosen masa administrative të kërkohej kallëzim penal në zbatim të nenit 131 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, pikat 130-132 të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 24, datë 02.09.2008" Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Kodit Penal i RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 -Mospagimi i taksave dhe tatimeve .

d- Drejtoria e Taksave dhe Tarifave të evidentojë abonentët familjarë për të cilët nuk janë aplikuar detyrimi për taksën/tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit për periudhën 2012 -2015 , në zbatim të pikës 52 të Udhëzimit Plotësues të buxhetit të Ministrisë Financave nr. 03, datë 17.01.2014 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2014", të hartohen njoftim vlerësimit në zbatim të nenit 70, pika 3-E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor, nenin 32, të ligjit nr. 9920, datë 19/5/2008 " Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe nenin 4, të ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 "Për Sistemin e Taksave Lokale" me ndryshime .

Brenda datës 31.12.2015

8. Gjetje: Nuk janë shlyer detyrimet kreditore, për vitin 2013-2014 në shumën **13,626,410 lekë** ndaj subjekteve të ndryshme, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 24.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare", ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

8.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës në komunën Perondi të marrë masa, dhe të kryej pagesat e të shlyej detyrimet ndaj kreditorëve në shumën **13,626,410 lekë**, si detyrime të prapambetura e pashlyer nga viti 2013-2014.

Brenda datës 31.12.2015

9. Gjetje: Për vitin 2013 komuna Perondi, nuk ka bërë hyrje në magazinë Projektin e rrugës Distributor-Rreth Tapi në vlerën **474.600 lekë**, veprim në kundërshtim me UMF. 30 datë "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" .

9.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës në komunën Perondi të marrë masa dhe të bëjë hyrje në magazinë "Projektin e rrugës Distributor-Rreth Tapi", në vlerën **474.600 lekë**.

Vazhdimisht

10. Gjetje: Pasuritë e transferuara me VKM nr. 378, datë 27.03.2008 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyjeve dhe kullotave, që do të transferohen në pronësi të njësisë vendore komuna Perondi të Qarkut të Berat", nuk ka bërë rivlerësimin e tyre dhe nuk i ka paraqitur në Pasqyrat Financiare të vitit 2013, 2014, veprim në kundërshtim me UMF. 30 datë "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

10.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa dhe të bëjë rivlerësimin e pasurive të paluajtshme, duke bërë paraqitjen reale të vlerave të tyre në Pasqyrat Financiare të vitit 2015.

Deri më datën 30.12.2015

11. Gjetje: Komuna nuk ka kushte me nivel sigurie, për ruajtjen e mjeteve monetare, por ruajtja e tyre bëhet në tavolinë prej druri, duke krijuar risk vjedhje të tyre. Në arkë janë mbajtur mjete monetare më shumë se kufiri i lejuar ligjor, duke mos i derdhur çdo ditë në Bankë, veprim në mospërputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve të njësisë së sektorit publik”.

11.1 Rekomandimi: Drejtuesit e komunës të marrin masa, për ruajtjen e mjeteve monetare sipas kërkesave ligjore në standarde sigurie, si dhe të mos mbahen mjete monetare në arkë më shumë se kufiri i lejuar ligjor.

Vazhdimisht

12. Gjetje: Mjetet e transportit të dhuruara nga donatorë të ndryshëm komunës, nuk administrohen(ruhen) brenda territorit të komunës, por ndodhen jashtë territorit të saj, veprim në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

12.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës deh zyra e Shërbimeve të marrë masa, që mjetet e transportit të jenë në ruajtje brenda territorit të komunës Perondi.

Vazhdimisht

13. Gjetje: Komuna Perondi për vitin 2013-2014, nuk ka miratuar leje zhvillimi ndërtimi, pasi në mungesë të specialistëve në fushën e urbanistikës. Komuna në mungesë të specialistëve urbanistë, këtë funksion duhet ta delegonte në Këshillin e Qarkut Berat, duke lidhur marrëveshje për miratimin e lejeve zhvillimore të ndërtimit, veprim në kundërshtim me pikës 2 të nenit 13, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar dhe neni 80, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit” i ndryshuar.

13.1 Rekomandimi: Komuna Perondi të delegojë funksionin mbi miratimin për leje zhvillimi ndërtimi dhe të lidh marrëveshje me Këshillin e Qarkut Berat, me qëllim zhvillimin e tokës në territorin e komunës.

Vazhdimisht

14. Gjetje: KRRT-ja e komunës Perondi për vitin 2007-2008, në një raste, ka miratuar leje shesh ndërtimi për karburant dhe shesh karburanti me sipërfaqe 700 m² në truall publik. Nga komuna Perondi, është lidhur kontratë qira trualli datë 24.02.2005, truall me sipërfaqe 200 m² për karburant me afat një vjeçar dhe me datë 04.09.2007, truall me sipërfaqe 500 m² shesh karburanti me afat një vjeçar, si dhe duke miratuar leje ndërtimi pa plan rregullues, veprim në kundërshtim me pikën 3 e 7 të nenit 22 dhe nenin 30, 35, 45 e 50, të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për urbanistikën”, i ndryshuar.

14.1 Rekomandimi: Komuna Perondi të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore lirin e truallit publik nga subjekti privat S...i H.....

Vazhdimisht

15. Gjetje: Në tenderin e zhvilluar për “Rikonstruksionin e rrugës Perondi-Lapardha” faza e parë, mungon projekti i plotë dhe pjesor origjinal, ose i

noterizuar për segmentin e fazës së parë të rrugës me preventivin sipas çmimeve të manualit. Në dosjen e Dokumenteve të Tenderit (DST), ekziston një preventiv i përgatitur nga persona të palicencuar dhe nuk ka vlerë ligjore.

15.1 Rekomandimi: Kryetari i Komunës, nëpërmjet Njesisë hartimit të dokumenteve të tenderit dhe Komisioni i vlerësimit të ofertave, të cilët janë përgjegjës për zhvillimin e tenderëve të marrin masa, që për pjesën e pa realizuar të fondit dhe punimeve e në vazhdimësi deri në përfundimin e plotë të veprës, të sigurojnë më parë dokumentacionin ligjor të projektit të lartpërmendur.

Vazhdimisht

16. Gjetje: Nga auditimi rezulton se situacionet pjesore të shërbimit të pastrimit të mbeturinave urbane të paraqitura nga sipërmarrësi për çdo muaj, nuk janë verifikuar me dokumente vërtetuese për shërbimet e kryera, sipas zërave të grafikut (libreza e punimeve), preventivit, si dhe nuk ka një situacion përfundimtar të krahasuar me preventivin për :

-Zëri paga punonjësish, Raportet ditore të punës të plotësuara nga sipërmarrësi, listë pagesat e kaluara me bankë, derdhjet e kontributit të sigurimeve sipas formularit përkatës, pagesa e tatimit mbi të ardhurat;

-Zëri materiale, karburanti i harxhuar sipas tipit të mjeteve dhe distancave të përshkruara bazuar në flet udhëtimet e plotësuara nga shoferët e operatorit;

-Zëri shpenzime të tjera i detajuar dhe në total, në përqindje mbi analizën e kostos së shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative.

Në zbatim të nenit 10, “Mbikëqyrja gjatë kryerjes së shërbimeve”, rezulton se veprimet e mësipërme përbëjnë shkelje të disiplinës financiare.

16.1 Rekomandimi: Kryetari i komunës dhe supervizori, të bëjnë mbikëqyrjen e situacionit pjesor të shërbimit të pastrimit për çdo muaj, duke u bazuar dhe kërkuar nga operatori dokumente që vërtetojnë kryerjen e punëve, blerjen e materialeve, pagesat pagave dhe sigurimeve shoqërore shëndetësore.

Vazhdimisht

17. Gjetje: Dosjet e subjekteve në sektorin e taksave dhe tarifave vendore, nuk janë të plota, nuk janë përditësuar dhe të plotësuara me dokumentacionin e nevojshëm, njoftim detyrimi nuk është konfirmuar nga administratori ligjor i subjektit. Gjithashtu në shumë raste, mungojnë deklaratat për gen-planet apo planimetritë (kjo për taksën e ndërtesave) dhe në asnjë rast, nuk ka procesverbal për verifikimin në terren të sipërfaqeve, ku subjekti ushtron veprimtarinë.

Duke vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në RSH”, neni 29, “Dosja e detyrimeve tatimore”, pika 1.

17.1 Rekomandimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të rishikojë dhe plotësojë dokumentacionin e munguar, në të gjitha dosjet e subjekteve të regjistruara. Dosjet të plotësohen dhe inventarizohen nga specialisti përkatës, duke evidentuar ato në dokumente e pasqyra përmbledhëse progresive e vjetore, me të dhënat për detyrimet, arkëtimet, kontrollet, llogaritjet e penaliteteve dhe përcaktimin e statusit të subjektit, konformë kërkesave ligjore.

Vazhdimisht

18. Gjetje: Nuk është përfshirë në treguesit e planit dhe të arkëtimit në fakt, taksa e fjetjes në hotel në masën 5 % për xhiron e realizuar nga hoteleria që operon në territorin e Komunës Perondi. Nga informacionet e marra u gjet se në territorin e

Komunës operon një hotel i paregjistruar, por që u paraqitën për regjistrim gjatë periudhës së auditimit.

18.1 Rekomandimi: Sektori i taksave dhe tarifave vendore i komunës, në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Berat, e cila në këtë rast është agjent tatimor, të verifikojnë regjistrat e mbajtura nga subjekti për vitin 2013, 2014 dhe 2015 dhe ti dokumentojnë ato me akt rakordim të plotë.

Brenda 3 mujorit të tretë

19. Gjetje: Mos realizimi në tërësi i arkëtimit të taksave, ka bërë që niveli i debitorëve në periudhën e audituar, por dhe më parë që nga viti 2011 të jetë në vlerën **16,633,954** lekë. Vlera debitore, rezulton të jetë **20,792,442** lekë, pasi këtu përfshihen penalitetet në shumën **4,158,488** lekë, të pa arkëtuara në buxhetin e komunës Perondi.

19.1 Rekomandimi: Komuna Perondi, nëpërmjet Sektorit të Taksave, të marrë masat e nevojshme organizative, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore e administrative të përcaktuara, për arkëtimin e këtyre detyrimeve në vlerën **20,792,442** lekë.

Brenda vitit 2015

20. Gjetje: Për ndjekjen e problemeve të aseteve për vitin 2013 dhe 2014, nuk ka punonjës të emëruar në strukturën organike, për pasojë nuk ka gjetur zbatim të plotë VKM nr. 974 datë 30.09.2009, ku është miratuar lista e inventarit të pronave aseteve të Komunës Perondi. Deri në periudhën e auditimit, nuk kanë kaluar në pronësi, si dhe nuk ka një akt të marrjes në dorëzim të aseteve të kësaj komune .

20.1 Rekomandimi: Të merren masa dhe të programohet puna, ku të përcaktohen nevojat e burimeve njerëzore, materiale e financiare, në kuadrin edhe të ndryshimeve të ardhshme të pushtetit vendor, për ndjekjen, administrimin dhe ruajtjen e aseteve dhe kalimit të tyre në pronësi të komunës apo bashkisë së re.

Brenda vitit 2015

21. Gjetje: Komuna Perondi , nuk ka lidhur kontratat e qirasë për 60 qiramarrës të tokës bujqësore, banorë të cilët e shfrytëzojnë këtë tokë, pa patur asnjë shkak ligjor justifikues. Në zbatim të pikës 5, të Udhëzimit të Ministrit Bujqësisë dhe Ushqimit nr. 1 datë 18.07.2012 dhe verifikimeve në terren nga Zyra e kadastrës, rezulton se sipërfaqet e tokave janë shfrytëzuar nga këta persona. Për periudhën 2013 dhe 2014, taksa e qirasë e pa llogaritur dhe e pa arkëtuar, rezulton në shumë **380,967** lekë.

21.1. Rekomandimi: Nga Kryetari i Komunës Perondi, Sektori i Mbrojtjes së Territorit dhe policia Komunale, sektori i Taksave vendore, të merren masa të përshkallëzuara sipas Procedurave Tatimore dhe Administrative, për mos arkëtimin e qirasë së tokës, nga fituesit e ankandëve dhe që kanë shfrytëzuar këto sipërfaqe toke në vlerën **380,967** lekë, por që nuk pranojnë lidhjen e kontratës. Po kështu të kryhen llogaritjet e detyrimeve për taksën e tokës që i përket vitit 2015 dhe të kryhet arkëtimi i tyre.

Brenda 3 mujorit të tretë

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar, kreu IV, nenet 9-14, ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, kreu I,

nenet 105-109 dhe udhëzimin e Ministrit të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" Kap IV, Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësit Autorizues), të nxirren aktet administrative dhe (Nëpunësi zbatues), të kryejë kontabilizimet, duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore, administrative dhe procedurat përmbartimore me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në vlerën **1,402,374 lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje: Me vendim të këshillit Komunës Perondi, 30 punonjës të administratës kanë përfituar padrejtësisht rritje pagë në shumën **380,914 lekë**, veprim në kundërshtim me VKM nr. 1619, datë 02.07.2008 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore" i ndryshuar.

1.1 Rekomandimi: Komuna Perondi të marrë masa dhe të vlerësojë e rillogarisë detyrimet për 30 punonjës të administratës, që kanë përfituar padrejtësisht pagë në shumën **380,914 lekë**, sipa listës së detajuar në Raportin Perfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 30.12. 2015

2. Gjetje: Në Komunën Perondi, janë përfituar padrejtësisht nga 18 këshilltarë, pagesa për pjesëmarrje në mbledhje të këshillit të komunës, ndërkohë që sipas protokollit të mbledhjeve, rezulton se nuk kanë marrë pjesë për periudhën 2013-2014 në vlerën **388,450 lekë**. Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 16, të VKM nr. 1619, datë 2.7.2008, i ndryshuar.

2.1 Rekomandimi: Komuna Perondi të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **388,450 lekë**, sa përfituar tepër nga **18 anëtarët e këshillit**.

Brenda datës 30.12. 2015

3. Gjetje: Për pajisjen me numër telefoni celulari të kryetarit të komunës, janë paguar nga llogaria e shpenzimeve operative të buxhetit të komunës në shumën **240,702 lekë**, veprim në kundërshtim me pikën 11, Lidhja nr. 6, të VKM nr. 864, datë 23.07.2010 "Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridik, publik".

3.1 Rekomandimi: Komuna Perondi të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore, arkëtimin e vlerës **240,702 lekë**, sa përfituar padrejtësisht nga R.H, për shpenzime telefoni celular, për periudhën 2013-2014.

Brenda datës 30.12.2015

4. Gjetje: Për periudhën 2013-2014, Drejtoria e Mirëmbajtjes së Rrugëve e komunës, ka harxhuar benzinë në shumën **296,408 lekë**, pa preventiv dhe situacion, por me orë punë në çdo muaj për motokorrëse bari. Kjo Drejtori nuk disponon inventarin e sipërfaqeve të gjelbra në pronësi të komunës, të cilat duhet të jetën pjesë e aseteve me vlerë dhe të kontabilizuar dhe të jenë paraqitur në pasqyrat financiare, veprim në mospërputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

4.1 Rekomandimi: Komuna Perondi të kërkojë në rrugë ligjore, arkëtimin e vlerës **296,408 lekë**, sa shpenzuar benzinë pa preventiv dhe situacion nga z. B.H, Drejtor i Mirëmbajtjes së Rrugëve për periudhën nga viti 2013 deri me 31.03.2015.

Brenda datës 30.12.2015

5. Gjetje: Për vitin 2013 janë paguar shpenzime pritje përcjellje në shumën **95,900 lekë**, veprim në mospërputhje me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM nr. 258, datë 03.06.1999 “Për shpenzimet për pritjen, përcjelljen dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja”, i ndryshuar

5.1 Rekomandimi: Komuna Perondi të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **95,900 lekë**, sa paguar shpenzime pritje përcjellje nga R.H, me detyrë kryetar komune dhe F.P, me detyrë Drejtor i Financës dhe Tatim Taksave.

Brenda datës 30.12.2015

6. Gjetjet: Komuna Perondi ka kryer pagesa të tepërta në vlerën **3,451,300 lekë**, ndaj operatorit ekonomik “G.... C.....” shpk., në situacionimin e volumeve të punës për 3 zëra punimesh me diferencë volumesh të pa kryera, në objektin “Rikonstruksion i rrugës Magjatë-Goraj-Velagosht, faza e I”, Komuna Perondi”, në kundërshtim me kushtet e kontratës nr. 876, datë 16.10.2012.

6.1 Rekomandimi: Komuna Perondi të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **3,451,300 lekë**, ndaj operatorit ekonomik “G....G. Co.....” shpk. Për situacionimin dhe pagesën e padrejtë të volumeve të punës, për 3 zëra punimesh me diferenca volumesh të pa kryera, në objektin “Rikonstruksion i rrugës Magjatë-Goraj-Velagosht, faza e I”, Komuna Perondi”.

Brenda datës

30.09.2015

7. Gjetje: Komuna Perondi ka kryer pagesa të tepërta në vlerën **1,896,906 lekë**, ndaj bashkimit të operatorëve ekonomik “B.....B” sh.p.k. dhe “B....i” shpk, në situacionimin e volumeve të punës për 4 zëra punimesh, me diferenca volumesh të pa kryera, në objektin “Ndërtim i KUZ fshati Magjatë”, Komuna Perondi”, në kundërshtim me kushtet e kontratës nr. 852, datë 28.09.2012 (*Trajtuar më hollësisht në faqen 39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1 Rekomandimi: Komuna Perondi të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **1,896,906 lekë**, ndaj bashkimit të operatorëve ekonomik “B.....B” shpk dhe “B....” shpk, në situacionimin dhe pagesën e padrejtë për volumet e punës të pa kryera, në 4 zëra punimesh, në objektin “Ndërtim i KUZ fshati Magjatë”, Komuna Perondi”.

Brenda datës 30.09.2015

8. Gjetje: Tenderi për prokurimin me fonde publike me objekt “*Shërbim i pastrimit të mbeturinave urbane*”, është zhvilluar në vitin 2008. Sipas Urdhër prokurimit nr. 73, datë 01.10.2008, firmosur nga ish-Kryetari i Komunës Perondi z. R.O, i cili me Urdhërin nr.17, datë 05.05.2010, ka vendosur rishikimin e vlerës së kontratës duke e rritur për shumën **216 530 lekë**, sipas pikës 14.1 të saj , në masën 3.5 % si rrjedhojë e indeksimit të rritjes të çmimit të publikuar nga INSTAT. Ky veprim është në kundërshtim me VKM Nr. 1. datë 10.01.2007, Rregullat e Përgjithshme të Prokurimit pikën b) ku citohet se “ *Për kontratat shumëvjeçare ose*

kontratat me mundësi ripërtëritjeje, autoriteti kontraktor, duhet të parashikojë klauzola për rishikimin e vlerës, në përputhje me inflacionin e publikuar.”

8.1 Rekomandimi : Komuna Perondi të kërkojë në rrugë ligjore, arkëtimin e vlerës **216,530 lekë** nga subjekti “H...” shpk, sa paguar padrejtësisht në rritjen e vlerës së kontratës, për arsye të inflacionit të përgjithshëm.

Brenda datës 30.09.2015

9-Gjetje: Në tenderin e zhvilluar për *Hartimin e planit të Përgjithshëm Vendor të Teritorit të “Komunës Perondi.”* në bazë të DST, pka 5.8, sipas formulës është llogaritur oferta anomalisht më e ulët, ku është përcaktuar vlera e ofertës së paraqitur nga subjekti H.P për shumën **3,890,000 lekë**. Nga auditimi rezulton se ky skualifikim është i pa bazuar në kërkesat specifike të DST. Për rrjedhojë firma “Hazbiu Projekt”, është skualifikuar padrejtësisht dhe diferenca ekëtij skualifikimi të padrejtë me efekt negativ në përdorimin e fondeve publike, është në shumën **470,000lekë**.

9.1 Rekomandimi: Kryetari Komunës Perondi, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, të marrë masat e nevojshme dhe të nxjerrë përgjegjësinë, duke kërkuar arkëtimin e shumës **470,000 lekë**, nga z. E.M, Kryetar, F.P dhe D.GJ antarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

C. MASA DISIPLINORE.

c. 1 Mbështetur në nenet 37, 141, 153 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996 dhe nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, si dhe në kontratën individuale të punës, kërkojmë nga **Kryetari i Komunës Perondi**, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore, nga “**Vërejtje**” deri në “**Largim nga Shërbimi civil**”, për punonjësit me status të nëpunësit civil, ndërsa për punonjësit me kontratë pune, të jepen masa “**Vërejtje**” deri në “**Ndërpreje të marrëdhënieve të punës**”, për këta persona:

- 1. R. B, me detyrë inspektore finance.**
- 2. B.M, me detyrë arkëtare.**
- 3. F.P, me detyrë Drejtor i Urbanistikës dhe Ruajtjes së Ambientit**

Për shkeljet e mëposhtme:

-Për të metat e mangësi të konstatuara, në zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore për miratimin e projekt buxhetit të komunës për vitin 2013, 2014 dhe 2015, në mospërputhje me pikën 8 neni 19, pika 2 neni 29, 32, 33, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin e funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, neni 6, 17, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 40, të ligjit nr. 10119, datë 29.04.2009 “Për planifikimin e Territorit”, të ndryshuar, VKM nr. 502, datë 13.07.2011 “Për miratimin e Rregullores uniformë të kontrollit të zhvillimit të territorit”, të ndryshuar,

-VKM nr. 1619, datë 02.07.2008 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të

punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”, të ndryshuar, ligjin nr. 9228, datë 24.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare”

- Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, pika 85, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nenin 111, të ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, VKM nr. 290, datë 14.06.1993 “Për limitin e arkës në ndërmarrjet shtetërore”, shkronjën “ç” pika 2, Kreu VI, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, pikën 5, të UMB nr. 1151, datë 16.07.2007 “Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit dhe asgjësimit të aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese në sistemin e Ministrisë Brendshme”.

II. V.A me detyrë specialiste mjedisi dhe në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, në tenderin me objekt “*Ndërtim i KUZ fshati Magjatë, Komuna Perondi*”, për shkeljet e mëposhtme:

- Për të meta dhe mangësi në përcaktimin e vlerës së fondit limit në preventivin e tenderuar, me objekt “*Ndërtim i KUZ fshati Magjatë, Komuna Perondi*”, ku nga llogaritja e gabuar në përcaktimin e vlerës së fondit limit, është shkaktuar shkelje e disiplinës financiare **me dëm ekonomik për buxhetin e komunës, në vlerën 3,527,775 lekë**.

D. MASA ADMINISTRATIVE

D.1- MINISTRINË E ZHVILLIMIT URBAN

Mbështetur në nenin 5/b të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”, i ndryshuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014 dhe nenin 15 “Sanksionet”, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe bazuar në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për shkelje të ligjshmërisë në mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve të ndërtimit, i kërkojmë **Ministrisë së Zhvillimit Urban**, që ka në juridiksion territorin ku ndodhen objektet e trajtuara sipas kontratave (duke i bashkëlidhur fotokopjen e procesverbalit përkatës që trajton çështjen), që të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur sanksionet si më poshtë:

-Vlerësim për masë dënimit me gjobë për mbikëqyrësit e punimeve të ndërtimit, si më poshtë:

Nga auditimi mbi hartimin e projekt dhe preventivit për objektin: “Kanalizimi i ujërave të zeza (KUZ) të fshatit Armen” të prokuruar në vitin 2013, u konstatuan shkelje të kërkesave të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar.

Bazuar në germën “ç” të nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, date 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, bazuar në VKM nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së Licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ndryshuar me VKM nr. 92, date 19.02.2014, Kreu VII, “Sanksione”, pika 1, shkronja (a), Pika I- Konstatohen ose provohen deklarime, të rreme, rekomandojmë Komisionin e dhënies së

Licencave, pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban, që për shkelje të ligjshmërisë në ndërtim të vendosë sanksionet **“Gjobë”** deri në **“Heqje e Licencës së ushtrimit të profesionit,”** për:

1. znj.V.Z, mbikëqyrës i punimeve, me licencë nr. MK 1148, me të cilën është lidhur kontrata nr. 879, datë 22.10.2012, me vlerë të përcaktuar **573,000** lekë, pa TVSh, për mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve të ndërtimit për objektin **“Rikonstruksion i rrugës Magjatë-Goraj-Velagosht, faza e I”**, Komuna Perondi, për shkak se:

a-Punimet e ndërtimit nuk janë zbatuar në përputhje me kushtet teknike të projektimit e të zbatimit dhe librezat e masave për përshkrimin e punimeve sipas grafikut dhe projekt zbatimit, nuk pasqyron me vërtetësi punimet e kryera për të përcaktuar saktë volumet e punimeve. Si rezultat i situacionimit të tre zëra punimesh, me diferenca volumesh të pa kryera në vlerën **3,451,300 lekë pa TVSh, ka krijuar mundësinë e përfitimit të pa drejtë nga operatori ekonomik **“G C...y” sh.p.k.** .**

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me neni 3, Kreu I, ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 **“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”**, i ndryshuar, Vendimin Nr. 514, datë 15.08.2007 **“Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit, ndryshuar me vendim nr. 664, datë 26.09.2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në pikat 2, 3 dhe 9 të VKM nr. 514, datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”**.

2. Për N.M , mbikëqyrës i punimeve, me nr. MK 0992/2, me të cilën është lidhur kontrata me datë 01.10.2012, me vlerë të përcaktuar **480.000** lekë, pa TVSh, për mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve të ndërtimit për objektin **“Ndërtim i KUZ fshati Magjatë”**, Komuna Perondi, për shkak se:

a-Punimet e ndërtimit nuk janë zbatuar në përputhje me kushtet teknike të projektimit e të zbatimit dhe librezat e masave për përshkrimin e punimeve sipas grafikut dhe projekt zbatimit, nuk pasqyron me vërtetësi punimet e kryera për të përcaktuar saktë volumet e punimeve. Si rezultat i situacionimit të katër zëra punimesh, me diferenca volumesh të pa kryera në vlerën **1,896,906 lekë pa TVSh, ka krijuar mundësinë e përfitimit të pa drejtë nga bashkimi i operatorëve ekonomik **“B.....B” sh.p.k.** dhe **“B...i” sh.p.k.** .**

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me neni 3, Kreu I, ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 **“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”**, i ndryshuar, Vendimin Nr. 514, datë 15.08.2007 **“Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit, ndryshuar me vendim nr. 664, datë 26.09.2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në pikat 2, 3 dhe 9 të VKM nr. 514, datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”**.

Shënim: Për punonjësen **F... Ç**, ish-anëtare e KRRT-së dhe në cilësinë e personit që ka mbajtur procesverbalin e mbledhjes larguar në vitin 2011, do të propozonim masë disiplinore **“Zgjidhjen e menjëhershme të kontratës të punës”**, por rekomandimi konsiderohet i ezauruar, pasi rezulton të jenë larguar nga institucioni përpara fillimit të auditimit dhe nuk ka adresim institucional, në këto kushte masën që do të propozonim e konsiderojmë të ezauruar.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Xhovan Domi, Qemal Shehu, Luan Kuka dhe Marvi Karalliu, më tej u shqyrtua nga z. Selfo Zenelaj kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve.